



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Metodologji e Kërkimit Shkencor dhe Kërkim
në Kontekstin Pedagogjik të Gjuhës së Huaj

Ngarkesa: 6 kredite ; 30 orë leksione, 30 orë seminare

Viti , Semestri kur zhvillohet: Viti II, Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program për ciklin Master i Shkencave Mësuesi në Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6,7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi mbi metodat kërkimore në fushën e gjuhës së huaj. Ajo mbulon fazat kryesore të kërkimit shkencor si: konceptualizimi, formulimi i çështjeve kërkimore, mbledhja dhe analiza e të dhënave, si dhe raportimi i rezultateve.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studentët njihen me dallimet midis kërkimit sasior dhe cilësor, rolin e kërkuesit dhe supozimet mbi realitetin, me fokus në kërkimin në klasë. Kursi përfshin analiza të studimeve ekzistuese dhe përfshirje praktike të studentëve në kërkim në shkallë të vogël, me synimin që ata të zhvillojnë dhe përdorin teknika të ndryshme kërkimi në gjuhësinë e aplikuar, kryesisht në kërkimin në klasë.

Rezultate të pritshme:

Në përfundim të kursit, studenti duhet të jetë i aftë të:

- formulojë çështje kërkimore dhe të analizojë të dhënat përkatëse, duke u bazuar në teknika cilësore të kërkimit,
- justifikojë metodat e përdorura në matjen dhe vlerësimin e gjuhës dhe mësimdhënies gjatë studimit,
- paraqesë rezultatet me vlerë për studiuesit dhe praktikën në të ardhmen,
- identifikojë dhe vlerësojë ndikimet shoqërore të kërkimeve dhe studimeve të tjera në fushë,
- vlerësojë në mënyrë kritike studimet e botuara në fushën e gjuhësisë së aplikuar,
- të shkruajë një propozim për kërkim duke përdorur metoda sasimore dhe cilësore dhe të shkruajë raporte, artikuj dhe prezantime të kërkimeve.